Made with Xodo PDF Reader and Editor

Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

08/5802/00-2558
10.10.2024

**Për:** Kryesinë e Kuvendit të Republikës së Kosovës
Z. Glauk Konjufca, Kryetar i Kuvendit të Republikës së Kosovës

**Nga:** Abelard Tahiri, Kryetar i Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës, në emër të deputetëve nënshkrues

**Lënda:** Kërkesë për Seancë të Jashtëzakonshme

**Data:** 11 tetor 2024

Në bazë të nenit 69, paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe të paragrafit 6 të nenit 68 të Rregullores së Kuvendit, i paraqesim Kryesisë së Kuvendit kërkesën për mbajtjen e Seancës së Jashtëzakonshme, më datë 11 tetor 2024, në ora 12:00, me këtë rend dite:

***Çështja:*** *Debat Parlamentar për komunikimet e kryetares së Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje Mimoza Kusari - Lila me Milan Radojiçiç;*

***Arsyetim***

Më datë 09 tetor 2024, në media u publikuan komunikimet e zhvilluara nga Kryetarja e GP- LVV Mimoza Kusari Lila me Milan Radoičić - person ky, i kërkuar në bazë të urdhër-arrestit ndërkombëtar nga organet e sigurisë së Republikës së Kosovës dhe në të njëjtën kohë i përfshirë në Listën e Zezë të SHBA-ve. Komunikimi me Radoičić dhe përmbajtja e bisedës telefonike mes tyre, e zhvilluar në koordinim të plotë me kryeministrin Kurti, apo në emër të tij, jo vetëm se është shqetësuese, por shpërfaq koordinimin dhe kushtëzimet e bëra në kanale joformale parapolitike, të cilat në thelbë cenojnë integritetin e institucioneve të Republikës së Kosovës e mbi të gjitha e sfidojnë vendimmarrjen e Kuvendit, si bartës i pushtetit legjislativ.

Nga kjo bisedë telefonike mes tyre, kuptohet se Mimoza Kusari-Lila nuk e ka thënë të vërtetën me rastin e deklarimit të saj për bisedat dhe komunikimet paraprake të publikuara një vit më parë, me ç'rast nuk e kishte thënë të vërtetën, pasi kishte mohuar se kishte biseduar në mënyrë të drejtëpërdrejtë me Radoičić dhe duke gënjyer po ashtu se për këto biseda kryeministri Kurti nuk ka qenë i informuar. Rrjedhimisht, Kuvendi është i obliguar që të debatoj hapur para publikut për pazaret apo

Made with Xodo PDF Reader and Editor

kushtëzimet e caktuara, të cilat përveç se e cenojnë punën e Kuvendit, po ashtu cenojnë rendë vlerat fundamentale të shoqërisë tonë, siç janë veteranët dhe kategoritë e tjera të luftës.

Fakti se kryetarja e GP- LVV Mimoza Kusari Lila i detyrohet komunikimit dhe kërkesave të Milan Radoičić, përbën në të njëjtën kohë edhe cenim të procesit hetimor që në kohën përkatëse ishte duke u zhvilluar ndaj tij, mbi bazën e të cilave hetime, i njëjti edhe kërkohej nga institucionet e sigursë ndërkombëtare.

Për më tepër, nga ky komunikim, përveç tjerash kuptohet se kryetarja e GP- LVV Mimoza Kusari Lila ishte koordinuar për agjendën e Kuvendit dhe formën e votimit - nga ana e Listës Serbe - të çështjeve në kuadër të kësaj agjende. Këto veprime konsiderojmë se përbëjnë rrethana të mjaftueshme të cilat ngrejnë shqetësime serioze të cilat e minojnë edhe besimin e publikut në punën dhe integritetit e Kuvendit të Republikës së Kosovës. Prandaj, sqarimi dhe llogaridhënja nga ana e saj, dhe e grupit parlamentar të LVV-së është së paku detyrë themelore përballë qytetarëve dhe betimit ndaj Kushtetutës.

Si deputetë parashtrues të kërkesës, konsiderojmë se kushtëzimi dhe koncesionet e kryetares së GP- LVV Mimoza Kusari Lila me Milan Radoičić lidhur me agjendën e Kuvendit apo konkretisht për çështjet si: zgjedhja e një gjyqtari të Gjykatës Kushtetuese dhe votimi i Ligjit për Pagën Minimale *(me emrin zyrtar: Ligji nr.08/L-142 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjeve që Përcaktojnë Shumën e Beneficionit në Lartësi të Pagës Minimale, Procedurat e Caktimit të Pagës Minimale dhe Shkallët Tatimore në të Ardhurat Personale Vjetore)* përbën një skandal të pashembullt për të cilin është detyrë e saj që të ofrojë sqarime lidhur me këto komunikime.

Prandaj, duke e konsideruar skandaloz dhe të pashembullt një koordinim të tillë, vlerësojmë se çështa meriton trajtim nga të gjitha institucionet e tjera duke përfshirë edhe Kuvendin e Republikës së Kosovës, përmes debatit parlamentar të propozuar me këtë kërkesë.

Si më sipër, deputetët nënshkrues të kësaj kërkese, mirëpresin caktimin e Seancës së Jashtëzakonshme nga Kryesia e Kuvendit, me qëllim të zhvillimit të debatit parlamentar për temën e lartshënuar me qëllim që të propozohen masa e veprime konkrete në funksion të evitimit të pasojave eventuale si rezultat i marrëveshjeve dhe/apo dakordimeve që kanë rezultuar nga ky komunikim dhe koordinim mes Kryetares së GP- LVV Mimoza Kusari Lila me Milan Radoičić.

Kjo kërkesë është e natyrës urgjente, sepse bazohet në nevojën që Kuvendi i Republikës së Kosovës të ushtroj përgjegjësitë kushtetuese si institucion ligjvënës i Republikës së Kosovës i zgjedhur drejtpërdrejt nga populli (neni 63).

***Bashkëngjitur:***
*Kërkesa me nënshkrimet e deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës për mbajtjen e Seancës së Jashtëzakonshme dhe draft-rezoluta e propozuar;*

Made with Xodo PDF Reader and Editor

Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

*Legjislatura VIII*

Në mbështetje të nenit 65.1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenin 6.1 të Rregullores së Punës së Kuvendit të Kosovës, Kuvendi i Republikës së Kosovës në seancën e jashtëzakonshme të mbajtur më 11 tetor 2024, me propozimin e Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës, Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, Grupit Parlamentar të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës dhe deputetëve të pavarur, miratoi këtë:

**(draft) R e z o l u t ë**

**Kuvendi i Republikës së Kosovës**

1. *Kërkon nga Prokurori i Shtetit si institucion kushtetues i pavarur me autoritet dhe përgjegjësi për ndjekjen penale, që të iniciojë hetime penale në përputhje me legjislacionin në fuqi ndaj kryetares së Grupit Parlamentar të LVV Mimoza Kusari Lila lidhur me komunikimet e saj me Millan Radoičić;*

2. *Kërkon nga GP –LVV shkarkimin e Mimoza Kusari Lila nga funksioni i kryetares së grupit parlamentar;*

Nr. __/__/ Prishtinë, __/__/ 2024

**Glauk Konjufca**

________________

**Kryetar i Kuvendit**

Made with Xodo PDF Reader and Editor

*Shtojcë e kërkesës për mbajtjen e Seancës së Jashtëzakonshme - nënshkrimet e deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës*

*Çështja:* ***Debat parlamentar për komunikimet e kryetares së GP të LVV Mimoza Kusari-Lila me Milan Radojicic;***

- Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK)

| Emri | Mbiemri | Nënshkrimi |
|---|---|---|
| 1. Abelard | Tahiri | [signature] |
| 2. Ardian | Kastrati | [signature] |
| 3. Ariana | Musliu – Shoshi | [signature] |
| 4. Bekim | Haxhiu | [signature] |
| 5. Blerta | Deliu – Kodra | |
| 6. Eliza | Hoxha | [signature] |
| 7. Elmi | Reçica | [signature] |
| 8. Enver | Hoxhaj | [signature] |
| 9. Ferat | Shala | [signature] |
| 10. Floretë | Zejnullahu | [signature] |
| 11. Ganimete | Musliu | [signature] |
| 12. Hajdar | Beqa | [signature] |
| 13. Hisen | Berisha | [signature] |
| 14. Isak | Shabani | [signature] |
| 15. Memli | Krasniqi | [signature] |
| 16. Mergim | Lushtaku | [signature] |
| 17. Rashit | Qalaj | [signature] |
| 18. Xhavit | Haliti | [signature] |

Made with Xodo PDF Reader and Editor

**Dasara Peci**

**From:** Blerta Deliu Kodra
**Sent:** Thursday, October 10, 2024 2:07 PM
**To:** Dasara Peci

**Titulli:** Shprehje e vullnetit për thirrjen e Seancës së Jashtëzakonshme

**Çështja:** *Debat parlamentar për komunikimet e kryetares së GP të LVV Mimoza Kusari-Lila me Milan Radojicic;*

**Data:** 10 tetor 2024

I nderuar,

Pas konsultimit me kryetarin e Grupit Parlamentar, përmes këtij emaili, në mbështetje të paragrafit 6 të nenit 68 (Seanca e Jashtëzakonshme) e Rregullores së Kuvendit, konfirmoj vullnetin tim për thirrjen e Seancës së Jashtëzakonshme për çështjen e lartëcekur.

Deklarimin e vullnetit tim në mënyrë elektronike, e bëjë për shkak të pamundësisë objektive që sot të jem fizikisht në Kuvend.

Faleminderit përmirëkuptimin tuaj!

Me nderime

Blerta Deliu Kodra

Sent from my iPhone

Made with Xodo PDF Reader and Editor

*Shtojcë e kërkesës për mbajtjen e Seancës së Jashtëzakonshme - nënshkrimet e deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës*

*Çështja:* ***Debat parlamentar për komunikimet e kryetares së GP të LVV Mimoza Kusari-Lila me Milan Radojicic;***

- *Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK)*

| Emri | Mbiemri | Nënshkrimi |
|---|---|---|
| 1. Arben | Gashi | [signature] |
| 2. Agim | Veliu | [signature] |
| 3. Anton | Quni | [signature] |
| 4. Armend | Zemaj | [signature] |
| 5. Avdullah | Hoti | [signature] |
| 6. Behxhet | Pacolli | |
| 7. Besian | Mustafa | [signature] |
| 8. Doarsa | Kica – Xhelili | |
| 9. Driton | Selmanaj | [signature] |
| 10.Hikmete | Bajrami | [signature] |
| 11. Kujtim | Shala | [signature] |
| 12. Lumir | Abdixhiku | |
| 13. Marigona | Geci | |
| 14. Rrezarta | Krasniqi | [signature] |
| 15. Valentina | Bunjaku-Rexhepi | [signature] |
| 16.Vlora | Dumoshi | [signature] |

Made with Xodo PDF Reader and Editor



# hprehje e vullnetit për thirrjen e Seancës së Jashtëzakonshme

Behgjet Pacolli

Thu 10/10/2024 10:15 PM

To:Yllka E. Gashi <Yllka.E.Gashi@assembly-kosova.org>;

nderuar,

ështja: Debat Parlamentar për komunikimet e kryetarës të GP të LVV Mimoza Kusari- Lila me Milan Radojiçiç

as konsultimit me kryetarin e Grupit Parlamentar, përmes këtij emaili, në mbështetje të paragrafit 6 të nenit 68 (Seanca e ıshtëzakonshme) e Rregullores së Kuvendit, konfirmoj vullnetin tim për thirrjen e Seancës së Jashtëzakonshme për çështjen e ˈtëcekur.

eklarimin e vullnetit tim në mënyrë elektronike, e bëjë për shkak të pamundësisë objektive që sot të jem fizikisht në Kuvend.

ıleminderit përmirëkuptimin tuaj!

e nderime
ehgjet Pacolli






# itulli: Shprehje e vullnetit për thirrjen e Seancës së Jashtëzakonshme

Lumir Abdixhiku

Thu 10/10/2024 9:58 PM

To:Yllka E. Gashi <Yllka.E.Gashi@assembly-kosova.org>;

ështja: Debat Parlamentar për komunikimet e kryetarës të GP të LVV Mimoza Kusari- Lila me Milan Radojiçiç

ata: 10 tetor 2024

nderuar,

as konsultimit me kryetarin e Grupit Parlamentar, përmes këtij emaili, në mbështetje të paragrafit 6 të nenit 68 eanca e Jashtëzakonshme) e Rregullores së Kuvendit, konfirmoj vullnetin tim për thirrjen e Seancës së shtëzakonshme për çështjen e lartëcekur.

eklarimin e vullnetit tim në mënyrë elektronike, e bëjë për shkak të pamundësisë objektive që sot të jem fizikisht ë Kuvend.

aleminderit përmirëkuptimin tuaj!

le respekt,
umir Abdixhiku




---



Made with Xodo PDF Reader and Editor

**Shtojcë e kërkesës për mbajtjen e Seancës së Jashtëzakonshme - nënshkrimet e deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës – GP AAK**

Çështja: Debat parlamentar për komunikimet e kryetares së GP të LVV Mimoza Kusari-Lila me Milan Radojiçiç;

## Lista e deputetëve nënshkrues

| Nr. | Emri dhe mbiemri | Grupi Parlamentar | Nënshkrimi |
|---|---|---|---|
| 1 | Besnik TAHIRI | AAK | [signature] |
| 2 | Pal Lekaj | AAK | [signature] |
| 3 | Ramush Haradinaj | AAK | [signature] |
| 4 | Time Kadrijaj | AAK | [signature] |
| 5 | Albana Bytyqi | AAK | [signature] |
| 6 | Shemsedin Dreshaj | AAK | [signature] |
| 7 | [illegible] | AAK. | B B |
| 8 | | | |
| 9 | | | |
| 10 | | | |
| 11 | | | |
| 12 | | | |
| 13 | | | |
| 14 | | | |
| 15 | | | |

Made with Xodo PDF Reader and Editor

*Shtojcë e kërkesës për mbajtjen e Seancës së Jashtëzakonshme - nënshkrimet e deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës*

*Çështja: <u>Debat parlamentar për komunikimet e krvetares së GP të LVV Mimoza Kusari-Lila me Milan Radojicic;</u>*

| Emri | Mbiemri | Nënshkrimi |
|---|---|---|
| 1. Fatmir | Humolli | [signature] |
| 2. | | |
| 3. | | |
| 4. | | |
| 5. | | |

Made with Xodo PDF Reader and Editor

*Shtojcë e kërkesës për mbajtjen e Seancës së Jashtëzakonshme - nënshkrimet e deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës*

*Çështja: Debat parlamentar për komunikimet e kryetares së GP të LVV Mimoza Kusari-Lila me Milan Radojicic;*

| Emri | Mbiemri | Nënshkrimi |
|---|---|---|
| 1. Haki A | Abazi | [illegible] |
| 2. | | |
| 3. | | |
| 4. | | |
| 5. | | |

Made with Xodo PDF Reader and Editor

Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

---

**VIII saziv**

U prilog članu 65.1 Ustava Republike Kosovo i članu 6.1 Poslovnika Skupštine Kosova, Skupština Republike Kosovo je na vanrednoj sednici održanoj I I. oktobra 2024. godine, na predlog parlamentranih grupa Demokratske partije Kosova, Demokratskog saveza Kosova, Alijanse za budućnost Kosova i nezavisnih poslanika, donela sledeću :

**(nacrt) Rezoluciju**

**Skupština Republike Kosovo**

1. Zahteva od Državnog tužioca, kao nezavisnu ustavnu instituciju sa ovlašćenjem i odgovornošću za krivično gonjenje, da pokrene krivičnu istragu u skladu sa zakonima na snazi protiv predsedavajuće parlamentarne grupe VV Mimoza Kusari Lila u vezi sa njenom komunikacijom sa Milanom Radoičićem;

2. Zahteva od PG -VV razrešenje Mimoza Kusari Lila sa funkcije predsedavajuće parlamentarne grupe;

Br. __/__/ Priština, __/__/ 2024.

Glauk Konjufca

____________________

Predsednik Skupštine